



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*  
*Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine – Ministry of Labour and Social Welfare*

---

*23.02.2021, Prishtinë*

**FTESË PËR APLIKIM**

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR PROJEKTET E OJQ-VE NGA  
FUSHA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim MPMS fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës 23.02.2021 të publikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të;
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

**Të drejtë aplikimi kanë**

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme.

### **Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte**

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

### **Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente**

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar apo angazhuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: [adelina.hasani@rks-gov.net](mailto:adelina.hasani@rks-gov.net) deri me datën **15.03.2021**.

Aplikimin mund ta bëni po ashtu, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sheshi Miss Edit Durham nr.46, pranë Hotelit Grand, 10 000, Prishtinë - Zyra e Personelit në MPMS.

MPMS do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës **23.02.2021** të publikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.